



British Embassy
Pristina

Udhëzues mbi paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (Paditë SLAPP)

Për anëtarë të organizatave joqeveritare,
gazetarë, profesionistë të mediave dhe aktivistë



Udhëzues mbi paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (Paditë SLAPP)

Për anëtarë të organizatave joqeveritare,
gazetarë, profesionistë të mediave dhe aktivistë

TITULLI:

**Udhëzues mbi paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike
(Paditë SLAPP)**

Për anëtarë të organizatave joqeveritare, gazetarë,
profesionistë të mediave dhe aktivistë

AUTOR:

Albana Hasani

EDITOJ:

Lëvizja FOL
Chemonics UK

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Pilot Projekti SLAPP për Kosovë (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) është i mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë dhe zbatohet nga Chemonics UK. Ky udhëzues synon që të ngris vetëdijen e palëve të ndryshme, si anëtarëve të organizatava joqeveritare, gazetarëve, profesionistëve të ndryshëm të mediave dhe aktivistëve, për të kuptuar se si përdoren SLAPP dhe si të merren masa kundër tyre.

Publikimi i këtij udhëzuesi mbështetet nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë në kuadër të Pilot Projektit SLAPP për Kosovë. Opinionet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e Chemonics UK, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| 1. Hyrje | 6 |
| 2. Çfarë janë veprimet ligjore SLAPP dhe cili është qëllimi i tyre? | 2 |
| Çka janë paditë SLAPP? | 8 |
| Cili është qëllimi i padive SLAPP? | 8 |
| Cilat janë llojet e padive SLAPP? | 10 |
| Nga kush parashtrohen paditë SLAPP? | 11 |
| Ndaj kujt parashtrohen paditë SLAPP? | 11 |
| 3. Si mund të identifikohen paditë SLAPP? | 13 |
| 4. Cilat janë efektet e veprimeve ligjore SLAPP? | 14 |
| 5. Si mund të mbrohen të targetuarit prej veprimeve ligjore SLAPP? | 15 |
| 6. Përfundim | 20 |
| Shtojca | 21 |

1. Hyrje

Demokracitë bashkëkohore dhe individët që kanë për kauzë të mbrojnë interesin publik çdo ditë e më shumë po përballen me kërcënime të natyrave të ndryshme, si fizike, ekonomike, psikologjike apo ligjore, përfshirë edhe paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike, të njohura si Paditë SLAPP (Strategic Lawsuits Against Public Participation), të cilat po përdoren si mjet për të frikësuar dhe heshtur gazetarët, aktivistët dhe zërat kritikë në shoqëri.

Paditë SLAPP janë padi që synojnë të censurojnë, frikësojnë dhe heshtin kritikët, duke i detyruar të nënshtrohen ose të përballen me veprime ligjore dhe kosto të larta të këtyre procedurave, me qëllim detyrimin e tërheqjes së kritikave ndaj tyre. Këto padi minojnë angazhimin aktiv publik dhe përfaqësojnë një formë hakmarrjeje që cenon lirinë e shprehjes së aktivistëve dhe gazetarëve për çështjet me interes publik. Për më tepër, ato prekin edhe gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të cenueshme, të cilët shpesh kanë më pak burime për t'u mbrojtur nga këto procese të shtrenjta dhe të lodhshme psikologjikisht, duke i vendosur ata përballë sfidave edhe më të mëdha në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe pjesëmarrjen në debatet publike.

Termi "SLAPP" u përdor fillimisht nga profesorët George W. Pring dhe Penelope Canan në librin e tyre "SLAPPs: Getting Sued for Speaking Out" (1996). Që nga atëherë, ky koncept iu referohet padive të ngritura nga entitete të fuqishme, si korporata, zyrtarë publikë apo individë me ndikim, kundër personave ose organizatave që kanë shprehur kritika apo kanë ngritur shqetësime mbi çështje të interesit publik.

Paditë SLAPP minojnë lirinë e shprehjes dhe demokracinë, duke krijuar një klimë frikësimi dhe auto censure. Aktivistët, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile shpesh përballen me këto padi kur ekspozojnë korrupsionin, abuzimet e pushtetit ose çështje të ndjeshme politike dhe mjedisore.

Edhe pse paditësit e kanë të qartë që këto padi janë të pabaza, qëllimi i paditësve është të lodhin psikikisht dhe financiarisht të paditurit, duke i detyruar ata të ndalojnë aktivitetin e tyre. Pa mbrojtje adekuate ligjore dhe mekanizma parandalues, paditë SLAPP mund të bëhen një mjet efikas për të heshtur zërat kritikë në shoqëri. Prandaj, nevojitet përgjigje adekuate e shoqërisë dhe e institucioneve shtetërore ndaj padive SLAPP në mënyrë që të ndërtohen mekanizma parandalues për parashtuesit e këtyre padive.

Institucionet ndërkombëtare kanë reaguar fuqishëm ndaj rrezikut të padive SLAPP në Evropë. Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian kanë ndërmarrë hapa për të adresuar këtë problem dhe për të mbrojtur gazetarët dhe aktivistët e kërcënuar nga këto praktika abuzive. Këshilli i Evropës ka miratuar rezoluta dhe rekomandime që kërkojnë masa dhe rekomandime për gazetarët dhe aktivistët e rrezikuar. Ndërsa Parlamenti Evropian ka miratuar Direktivën Anti-SLAPP, e cila synon të ndalojë përdorimin e këtyre veprimeve ligjore për të heshtur kritikët. Këto institucione po punojnë për të forcuar mbrojtjen ligjore dhe për të parandaluar përdorimin e padive si mjet kërcënimi dhe censurimi.

Në këtë mënyrë, duke parë rritjen e përkushtimit të shteteve evropiane për të luftuar këtë fenomen, akterët relevant në Kosovë duhet pashmangshëm të bëhen pjesë e diskutimeve aktuale në këtë fushë, në mënyrë që të sigurohen që të mos rritet trendi i përdorimit të këtyre padive, duke e mbrojtur dhe garantuar kështu të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetarëve dhe aktivistëve.

Për më tepër, autoritetet e Kosovës duhet të veprojnë për të siguruar që të gjithë qytetarët t'a ushtrojnë lirinë e shprehjes, qasjen në informata dhe pjesëmarrjen publike pa pasur frikë nga hakmarrja, duke përfshirë paditë SLAPP ose format tjera të keqpërdorimit të sistemit të drejtësisë.

Ky udhëzues është krijuar për shoqërinë civile, gazetarët dhe aktivistët, me qëllim që t'ju ofroj informacion të qartë dhe praktik mbi paditë SLAPP. Synimi i tij është të ndihmoj lexuesit të kuptojnë çfarë janë këto padi, si mund të identifikohen, kush i inicion zakonisht dhe cilat janë mekanizmat ligjorë për t'u mbrojtur prej tyre.

Përmes këtij materiali, individët dhe organizatat e rrezikuara do të kenë një udhëzues të dobishëm për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të kundërshtuar taktikat ligjore të frikësimit dhe censurimit.

2. Çfarë janë veprimet ligjore SLAPP dhe cili është qëllimi i tyre?

Çka janë paditë SLAPP?

Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike janë veprime ligjore të cilat janë të pabazuara dhe abuzive, të iniciuara me qëllim për të frikësuar, heshtur dhe ndëshkuar individët apo organizatat që shprehin mendime kritike ose angazhohen në çështje me interes publik.¹

Këto lloj padish zakonisht përdoren nga individë të fuqishëm ose kompani për të frikësuar dhe heshtur kritikët e tyre. Qëllimi i tyre nuk është të fitojnë një çështje në gjykatë, por të shkaktojnë stres, shpenzime të larta, si dhe të ndikojnë qytetarët që të ndalojnë së foluri për çështje me interes publik.

Këto padi parashtrohen kundër gazetarëve, aktivistëve, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të zakonshëm, të cilët shprehin shqetësime mbi korrupsionin, dëmtimin e mjedisit, keqpërdorimin e pushtetit ose çështje të tjera me rëndësi publike.

Cili është qëllimi i padive SLAPP?

Veprimet ligjore që iniciohen përmes padive SLAPP synojnë të abuzojnë me procesin ligjor për të parandaluar, penguar, kufizuar ose penalizuar shprehjen e lirë për çështjet e interesit publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike.

Paditësit nuk kanë për qëllim kërkimin e drejtësisë apo realizimin e ndonjë të drejte vërtetë të cënuar, por heshtjen e kritikëve dhe frikësimin e tyre përmes presionit ligjor dhe shpenzimeve të larta. Në shumicën e rasteve, paditësit nuk presin të fitojnë çështjen në gjykatë, por synojnë që të paditurit të lodhen financiarisht dhe psikologjikisht, duke i detyruar të heqin dorë nga pjesëmarrja e tyre në çështje publike.

¹ Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Slapp.

Pra qëllimi i paditësve mund të përmblihet në këto pika: heshtja e atyre që guxojnë të kritikojnë publikisht për çështjet e interesit publik; frikësimi i të paditurve; censurimi; si dhe shkatërrimi i reputacionit të të paditurve.

Për më tepër, për të kuptuar qartë qëllimin e padive SLAPP është e rëndësishme të kuptohen drejtë definimet e dhëna në Rekomandimin e KiE-së për termat e mësipërm:

PJESËMARRJA PUBLIKE

i referohet të drejtës demokratike të secilit për të marrë pjesë në debatin publik dhe çështjet publike, online dhe offline, pa frikë apo diskriminim. Pjesëmarrja publike i referohet gjithashtu të drejtës së informimit dhe organizimit, si dhe të drejtës për të votuar dhe për të dalë në zgjedhje.²

INTERESI PUBLIK

i referohet të gjitha çështjeve që e prekin publikun dhe në të cilat publiku mund të ketë interes legjitim, veçanërisht ato çështje që kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme sociale ose që ndikojnë në mirëqenien e individëve ose jetën e komunitetit ose mjedisit.³

Rrjedhimisht, paditë të cilat kanë për qëllim censurimin e pjesëmarrjes publike dhe kufizimin e shprehjes së lirë për çështjet e interesit publik duhet kuptuar si padi SLAPP.

Paditë SLAPP zakonisht paraqiten si padi civile, por jo vetëm. Në disa raste ato mund të shoqërohen edhe me kërkesa të tjera ligjore, përfshirë kundërvajtje administrative, kallëzime penale ose masa ndëshkuese, të cilat përdoren për të ushtruar presion mbi kritikët. Këta mekanizma përdoren për të rritur presionin ndaj individëve ose organizatave që shprehin mendime kritike.

Një aspekt i rëndësishëm i SLAPP është faza paraprake, e njohur si "letrat ligjore", ku subjektet e synuara marrin kërcënime ose paralajmërime nga avokatët e paditësve. Këto letra shpesh kanë për qëllim të dekurajojnë vazhdimin e angazhimit publik ose të ndikojnë në tërheqjen e komenteve apo shprehjeve kritike përpara se të ngrihet zyrtarisht një padi. Në shumë raste, vetëm frika nga një proces gjyqësor i gjatë dhe i kushtueshëm është e mjaftueshme për të ndikuar në vetë censurë dhe për të penguar diskutimin e çështjeve me interes publik.

2 Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Slapp.

3 Po aty.

Cilat janë llojet e padive SLAPP?

Bazuar në Rekomandimin CM/Rec (2024)2 të Komitetit të Ministrave për kundërshtimin e përdorimit të padive SLAPP, format/llojet specifike të padive SLAPP përfshijnë:

- **Paditë SLAPP vendore:** Padi të ngritura brenda juridiksionit vendor, zakonisht nga akterë të fuqishëm kundër gazetarëve, aktivistëve, organizatave të shoqërisë civile ose qytetarëve të angazhuar në çështje publike. Këto padi synojnë të heshtin kritikën, të frikësojnë të paditurit dhe të pengojnë pjesëmarrjen publike.
- **Paditë SLAPP ndërkufitare:** Padi të ngritura në një apo më shumë juridiksione të huaja për të ushtruar presion mbi individë ose organizata në një vend tjetër. Këto lloj padish shfrytëzojnë dallimet ligjore midis vendeve dhe shpesh përdorin juridiksione ku ligjet janë më të favorshme për paditësin dhe më kufizuese për lirinë e shprehjes.
- **Paditë SLAPP të shumëfishta ose të koordinuara:** Padi të shumta të ngritura njëkohësisht ose në mënyrë të sinkronizuar kundër të njëjtit individ ose organizatë, me qëllim të rritjes së barrës financiare dhe psikologjike. Këto padi mund të jenë të ndryshme në natyrë (për shembull, padi për shpifje, dëmtim të reputacionit, shkelje të privatësisë, publikim të të dhënave personale), por të gjitha kanë të njëjtin qëllim: të pengojnë aktivitetin e personit apo organizatës që synohet.
- **Paditë SLAPP kundër pjesëmarrjes anonime të publikut:** Padi të drejtuara ndaj personave që kontribuojnë në diskutime publike në mënyrë anonime, duke synuar zbulimin e identitetit të tyre dhe frikësimin e mëtejshëm. Këto padi zakonisht parashtrohen ndaj përdoruesve të rrjeteve sociale apo platformave të tjera online ku personat në mënyrë anonime shprehin mendime kritike.

Këto forma të SLAPP-ve përdoren gjerësisht nga akterë të fuqishëm për të kufizuar hapësirën demokratike dhe për të ndaluar kritikën ndaj interesave të tyre, duke penguar lirinë e shprehjes dhe transparencën në shoqëri.

Nga kush parashtrohen paditë SLAPP?

Këto padi parashtrohen nga individë me pushtet, të cilët synojnë të heshtin kritikët dhe të shmangin mbikëqyrjen publike. Më poshtë ofrohet një listë joshteruese e subjekteve që në shumicën e rasteve parashtojnë paditë SLAPP:

- ✘ **Figura publike dhe politikanë** – Zyrtarë të lartë që synojnë të mbrojnë imazhin e tyre duke heshtur zërat kritikë.
- ✘ **Sipërmarrës të fuqishëm dhe kompani të mëdha** – Korporata të fuqishme, kompani të përfshira në tenderë publike apo sipërmarrës që synojnë të ndalojnë raportimet për aktivitetet e tyre të dyshimta.
- ✘ **Institucione shtetërore dhe publike** – Agjenci qeveritare, ndërmarrje publike apo organe shtetërore që përdorin paditë për të shmangur mbikëqyrjen dhe llogaridhënien.
- ✘ **Individë të fuqishëm në sektorë të ndryshëm** – Individë të lidhur me pushtetin dhe figura të tjera me ndikim.

Ndaj kujt parashtrohen paditë SLAPP?

Paditë SLAPP, që shpesh targetojnë individët dhe organizatat që angazhohen në çështje të interesit publik, parashtrohen ndaj atyre që kanë guximin të sfidojnë pushtetin dhe të kërkojnë transparencë. Këto padi parashtrohen kryesisht ndaj:

- ✘ **Gazetarëve dhe mediave** që ekspozojnë korrupsionin, keqpërdorimin e parave publike ose keq menaxhimin.
- ✘ **Aktivistëve të shoqërisë civile** që mbrojnë të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes dhe transparencën institucionale.
- ✘ **Qytetarëve të angazhuar** që denoncojnë publikisht shkeljet, nënshkruajnë peticione, organizojnë protesta apo shpërndajnë informacione për çështje me interes publik.
- ✘ **Avokatëve të të drejtave të njeriut** që mbrojnë viktimat e abuzimeve apo angazhohen në çështje të barazisë dhe drejtësisë sociale.

- ✘ **Hulumtuesve dhe studiuesve** që publikojnë analiza dhe studime kritike.
- ✘ **Grave, grupeve minoritare dhe personave të tjerë të marginalizuar** për të kufizuar aktivizmin e tyre në çështjet e interesit publik dhe për t'i frikësuar nga pjesëmarrja në debatet sociale. Paditë SLAPP përdoren gjithashtu për të heshtur në mënyrë të veçantë gratë aktiviste dhe gazetaret, të cilat përballen jo vetëm me sfidat ligjore, por edhe me sulme të dyfishta, duke përfshirë kërcënime gjinore dhe dhunë dixhitale.
- ✘ **Avokatëve që mbrojnë të drejtat e grave dhe minoriteteve** duke synuar të ndalojnë përpjekjet e tyre për të mbrojtur grupet e cenushme.

Me fjalë të tjera, nëse një qytetar (gazetar, aktivist etj.) ankohet publikisht ndaj veprimeve të ndonjë kompanie apo të ndonjë individi të famshëm e me pushtet, këta të fundit paguajnë avokatë për të ngritur padi në mënyrë që t'i frikësojnë ata, me qëllim që të njejtit të mos vazhdojnë të shprehin publikisht kritikën ndaj aktiviteteve të tyre.

Ndonëse paditësit e dinë mirë se paditë e tyre nuk do të kenë sukses në gjykatë, por duke e ditur se çështjet e tilla kërkojnë vite të tëra që të zgjidhen, e shfrytëzojnë këtë si rrethanë që të mbajnë të paditurit nën kërcënim përmes një procesi gjyqësor që zhvillohet ndaj tyre. Ndërkaq në anën tjetër, qytetarët shpesh nuk i kanë mjetet financiare për t'i bërë ballë shpenzimeve për të paguar mbrojtës që denjësisht do t'i përfaqësonin ata nëpër këto procese. Personat që janë cak të padive SLAPP përballen edhe me sfida të tjera financiare si shkas i padive SLAPP, që tejkalojnë nevojat financiare të mbrojtjes ligjore, meqenëse të njejtit përballen edhe me fushata denigruese të cilat ndikojnë në humbjen e vendit të punës në raste të caktuara, humbje të mundësive për zhvillim, etj. Pra efekti ekonomik dhe financiar është shumë i gjerë dhe dëmi që shkaktohet është skajshmërisht i lartë.

3. Si mund të identifikohen paditë SLAPP?

Bazuar në Rekomandimin CM/Rec(2024)2 të Këshillit të Evropës, indikatorët e mëposhtëm ndihmojnë për të dalluar paditë SLAPP nga paditë tjera legjitime. Këta tregues përfshijnë, por nuk kufizohen në këto elemente⁴:

- ✓ Paditësit përpiqen të shfrytëzojnë fuqinë e tyre financiare, politike apo shoqërore, për të ushtruar presion mbi të paditurit;
- ✓ Faktet e paraqitura nga paditësit janë të pabazuara në prova;
- ✓ Kërkesa e paditësve është joproporcionale ose e paarsyeshme në raport me pretendimet;
- ✓ Kërkesat e paditësve përbëjnë shpërdorim të drejtave ose procedurave;
- ✓ Paditësit angazhohen në zvarritjen e procedurave gjyqësore për të rritur shpenzimet e të paditurve me qëllim të shpërdorimit të drejtave procedurale;
- ✓ Kërkesat e paditësve i'u drejtohen personave fizik por jo ndaj personave juridik, me qëllim për t'ia penguar pjesëmarrjen publike.
- ✓ Kërkesat e paditësve shoqërohen nga një ofensivë e marrëdhënieve me publikun e krijuar për të ngacmuar, diskredituar ose frikësuar të paditurit me synimin që ta largojë vëmendjen nga çështja thelbësore në fjalë;
- ✓ Paditësit ose përfaqësuesit e tij përfshihen në frikësim ligjor, ngacmim ose kërcënim ndaj të paditurit;
- ✓ Paditësit ose palët e ndërlidhura me paditësin angazhohen në veprime juridike të shumëfishta dhe të koordinuara ose ndërkufitare për të njëjtën çështje ndaj të paditurve;
- ✓ Paditësit nuk i shfrytëzojnë mekanizmat tjerë jashtë-gjyqësorë për të zgjidhur kontestin.

Ndonëse paditë SLAPP nuk përfshijnë domosdoshmërisht të gjitha këto elemente, kur shumë nga këta tregues janë të pranishëm, veprimi juridik ka më shumë gjasa të konsiderohet si SLAPP.

4 Këta tregues janë përkthyer dhe përshtatur nga indikatorët e Rekomandimit CM/Rec (2024)2 të Këshillit të Evropës.

4. Cilat janë efektet e veprimeve ligjore SLAPP?

Efektet e këtyre padive janë të shumta dhe dëmtojnë jo vetëm individët e prekur, por edhe demokracinë dhe lirinë e shprehjes. Këto efekte përfshijnë kosto të mëdha financiare për të paditurin, presion ligjor dhe psikologjik, si dhe dëmtim të reputacionit dhe dekurajim.

Kostoja financiare: Një nga efektet kryesore që shkaktojnë paditë SLAPP është imponimi i një barre financiare mbi të paditurin. Edhe pse këto padi nuk kanë bazë të fortë ligjore, kostoja e përballjes me to mund të çojë në falimentim ose dorëheqje të të paditurit nga ndjekja e mëtejshme e kauzave publike. Pra, paditësit përmes padive SLAPP nuk synojnë t'a fitojnë çështjen në gjykatë, por të shkaktojnë barrë të rëndë financiare mbi të paditurit, duke i detyruar ata të tërhiqen nga debati publik.

Presioni psikologjik: Një ndër pasojat tjera të padive SLAPP është presioni psikologjik që u ushtrohet të paditurve. Individët që përballen me këto padi shpesh ndihen të frikësuar, të izoluar dhe të paaftë për të vazhduar angazhimin e tyre në çështjet e interesit publik. Në shumë raste, këto padi shoqërohen me kërcënime të tjera, si sulme ndaj integritetit profesional ose personal, duke krijuar një efekt frikësues mbi të gjithë ata që shprehen publikisht.

Dëmtimi i reputacionit: Të paditurit nga këto padi shpesh përballen me stigmatizim publik, duke u paraqitur si persona që përhapin informacione të rreme. Edhe kur padia është e pabazuar dhe përfundimisht hidhet poshtë nga gjykata, dëmi ndaj reputacionit mund të jetë i vazhdueshëm dhe i vështirë për t'u rikuperuar. Përveç këtyre, paditë e tilla kanë edhe efekt dekurajues, duke ndikuar që shumë individë dhe organizata të heqin dorë nga aktivizmi dhe nga denoncimi i shkeljeve.

Paditë SLAPP nuk kanë vetëm efekte të menjëhershme, por edhe ndikime afatgjata në lirinë e shprehjes dhe angazhimin qytetar. Frika e përpalljes me një proces gjyqësor të lodhshëm dhe të kushtueshëm çon në vetë censurë, ku individët dhe organizatat shmangin çështjet e ndjeshme ose kufizojnë fushën e raportimeve të tyre për të mos rënë në shënjestër të akterëve të fuqishëm.

Për të luftuar efektet negative të padive SLAPP, shumë vende kanë miratuar legjislacion kundër tyre, duke përfshirë ligje që mundësojnë hedhjen poshtë të këtyre padive në faza të hershme dhe parashikojnë dënime për ata që i përdorin ato në mënyrë abuzive. Megjithatë, nevoja për mbrojtje më të forta ligjore dhe ndërgjegjësim publik për këtë problem mbetet një sfidë e rëndësishme për garantimin e të drejtës së shprehjes dhe pjesëmarrjes publike.

5. Si mund të mbrohen të targetuarit prej veprimeve ligjore SLAPP?

Individët dhe organizatat që bëhen shënjestër e padive SLAPP kanë disa mënyra për t'u mbrojtur nga pasojat e tyre të dëmshme. Mbrojtja mund të arrihet përmes mekanizmave ligjorë, mbështetjes institucionale dhe përpjekjeve kolektive për të ngritur ndërgjegjësimin dhe për të forcuar kornizën ligjore mbrojtëse ndaj këtyre padive abuzive.

Një nga mënyrat më efektive për të sfiduar paditë SLAPP është ekspozimi i tyre në publik. Gazetarët, aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të përdorin mediat për të denoncuar se si këto padi synojnë të heshtin zërat kritikë. Në këtë mënyrë, përfshirja e publikut, komunitetit dhe institucioneve të ndryshme mund të krijoj presion mbi paditësit për të tërhequr paditë e pabazuara.

Çfarë duhet të kemi parasysh para publikimit të deklaratave? – Para publikimit të deklaratave duhet të sigurohet saktësia e informacionit që do të publikohet. Pra, që deklaratat të bazohen në fakte të verifikuara, të mbështetura në burime të besueshme, si dhe duke respektuar standardet etike dhe ligjore për të shmangur pretendimet për shpifje apo dëmtim të reputacionit.

Çfarë mbrojte parasheh legjislacioni në fuqi? - Aktualisht, Kosova ende nuk ka një ligj specifik anti-SLAPP dhe as nuk parashikon veprime lehtësuese ligjore duke e bërë më të vështirë mbrojtjen e individëve dhe organizatave që targetohen nga padi të tilla. Megjithatë, mbrojtja mund të arrihet përmes dispozitave të përgjithshme ligjore dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Rrjedhimisht, në mungesë të legjislacionit anti-SLAPP, një strategji efektive është edhe shfrytëzimi i instrumenteve ndërkombëtare si të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, të cilat mund të ofrojnë mbështetje dhe të ushtrjnë presion mbi institucionet për të adresuar këtë problem në mënyrë efektive.

Në lidhje me këtë, në prill të vitit 2024 për herë të parë u miratuan dy instrumente të rëndësishme për adresimin e problemit të padive SLAPP, duke synuar mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen publike nga veprimet ligjore abuzive. Këto instrumente përfshijnë:

Direktivën (BE) 2024/1096 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen e publikut nga pretendimet haptazi të pabazuara ose procedurat gjyqësore abuzive⁵;

Rekomandimin CM/REC (2024)2 të Komitetit të Ministrave për kundërshtimin e përdorimit të Padive SLAPP.⁶

Këto masa përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në nivel evropian për të luftuar përdorimin e padive SLAPP si një mjet për të heshtur gazetarët, aktivistët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Sipas Direktivës së BE-së, gazetarët dhe OJQ-të në vendet që janë pjesë e Bashkimit Evropian do të jenë në gjendje të apelojnë në gjykata për të përjashtuar çështjet gjyqësore që janë "qartësisht të pabazuara". Gjithashtu, direktiva parashikon mekanizma për refuzimin e hershëm të padive SLAPP si të pathemelta nga gjykatat; u lejon të paditurve të kërkojnë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga padi të tilla, si dhe parashikon sanksione ndaj paditësve që keqpërdorin sistemin gjyqësor për të shtypur zërat kritikë.

⁵ Gazeta Zyrtare e Unionit Evropian, Direktiva (EU) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2024/1096 mbi mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen e publikut nga pretendimet haptazi të pabazuara ose procedurat gjyqësore abuzive, miratuar me 11 prill 2024.

⁶ Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/REC (2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjik Kundër Pjesëmarrjes Publike, miratuar me 5 prill 2024.

Ndërsa Rekomandimi i KE-së nuk është ligjërish detyrues, por u rekomandon shteteve anëtare të miratojnë masa për parandalimin dhe kundërshtimin e padive SLAPP. Ky rekomandim, sugjeron krijimin e procedurave të përshpejtuara për rrëzimin e padive të pabazuara; inkurajon vendet të vendosin mekanizma mbështetës për viktimat e padive SLAPP, përfshirë ndihmën ligjore dhe financiare; thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së lirisë së shprehjes për të siguruar një mjedis të lirë dhe demokratik.

Çfarë procedure gjyqësore duhet të ndiqet dhe çfarë të pritet nga gjykatat? - Në sistemin gjyqësor të Kosovës, pas paraqitjes së padisë nga paditësi, i padituri ka të drejtë dhe detyrim të dorëzojë një përgjigje në padi për të kundërshtuar pretendimet e padisë. Kjo përgjigje është një hap thelbësor në procedurën kontestimore dhe duhet të përmbajë argumentet dhe provat që mbështesin mbrojtjen e të paditurit.

Në këtë fazë është e rëndësishme që të angazhohet një avokat, në mënyrë që të ndihmojë në identifikimin dhe përgatitjen e provave relevante për mbrojtje.

Legjislacioni vendor përcakton afate brenda të cilave i padituri duhet të dorëzojë përgjigjen e tij ndaj padisë. Është e rëndësishme që i padituri të respektojë këto afate për të shmangur pasojat negative në procesin gjyqësor. Gjykatat duhet të sigurojnë që çështja të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe pa vonesa të qëllimshme.

Në rast se gjykata vlerëson se padia është qartazi e pabazuar, përkatësisht se bëhet fjalë për padi SLAPP, gjykata vendos për refuzim të padisë, si dhe që paditësi të mbulojë të gjitha shpenzimet gjyqësore të të paditurit.

Me fjalë të tjera, në vazhdim janë paraqitur disa hapa të rëndësishëm që mund të ndërmerrni për t'u mbrojtur nga paditë SLAPP:



Siguroni saktësinë e informacionit para publikimit të deklaratave;



Angazhoni avokat të specializuar në lirinë e shprehjes dhe të drejtën civile;

- Për të siguruar mbrojtje ligjore, **Lëvizja FOL** ka krijuar një rrjet të organizuar të avokatëve dhe juristëve që ofron dhe koordinon mbështetje ligjore për çështjet që lidhen me lirinë e shprehjes për individët dhe organizatat që punojnë për të mirën e përgjithshme. Ky rrjet angazhohet në mënyrë **pro bono**, duke ndihmuar në mbrojtjen e fjalës së lirë dhe përballjen me paditë SLAPP.⁷

Prandaj, nëse jeni viktimë e një padie SLAPP, për asistencë ligjore mund të drejtoheni tek zyrat e **Lëvizjes FOL** në Prishtinë⁸, apo në adresën elektronike: info@levizjafol.org.

⁷ <https://levizjafol.org/anti-slapp/ndihme-juridike/>

⁸ Rruga Andrea Gropa, nr. 35, Prishtinë.




Dokumentoni çdo fakt ose komunikim që lidhet me çështjen, si raportet, publikimet, dëshmitë dhe çdo informacion tjetër që mund të mbështesë argumentin tuaj;



Respektoni afatet ligjore për të dhënë përgjigje në padi;



Kur gjykata vërteton se bëhet fjalë për padi SLAPP, ajo merr vendim për refuzimin e padisë dhe urdhëron që paditësi të mbulojë të gjitha shpenzimet gjyqësore të të paditurit.



**Mos u ndalni!
Liria e shprehjes është e drejtë themelore, prandaj mbrojeni atë.**

6. Përfundim

Paditë SLAPP paraqesin një kërcënim serioz për lirinë e shprehjes, gazetarinë e pavarur dhe aktivizmin qytetar. Ato përdoren si mjete ligjore për të frikësuar dhe heshtur zërat kritikë, duke ndikuar negativisht në demokraci dhe të drejtat e njeriut. Për këtë arsye, mbrojtja nga këto padi nuk është vetëm një çështje individuale, por një betejë kolektive për të drejtat dhe liritë themelore.

Për t'u mbrojtur nga këto padi, nevojitet mbështetje ligjore, bashkëpunim dhe angazhim i shoqërisë civile dhe mediave, si dhe ndërgjegjësim publik për t'i ekspozuar këto padi si mjete frikësimi dhe censurimi.

Lufta kundër padive SLAPP nuk është vetëm një çështje juridike, por edhe çështje e mbrojtjes së të drejtave demokratike. Prandaj është e rëndësishme që gazetarët, shoqëria civile dhe qytetarët aktivë të mobilizohen për të kundërshtuar këto padi dhe për të ushtruar presion për reforma ligjore që parandalojnë keqpërdorimin e sistemit të drejtësisë.

Ndikimi i padive SLAPP nuk është i njëjtë për të gjithë. Gratë, minoritetet dhe grupet e margjinalizuara shpesh përballen me pasoja më të rënda dhe janë më të cenueshme ndaj formave të ndryshme të frikësimit ligjor. Një qasje efektive kundër SLAPP duhet të marrë parasysh pabarazitë ekzistuese në shoqëri dhe të sigurojë që grupet më të cenueshme të kenë qasje të barabartë në mbrojtje institucionale dhe drejtësi pavarësisht gjinisë, statusit ekonomik apo përkatësisë etnike.

Paditë SLAPP nuk janë thjesht çështje individuale – ato prekin shoqërinë në tërësi duke minuar lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen demokratike. Me angazhim të vazhdueshëm, reforma të mirëfillta ligjore dhe mbështetje të ndërsjellë, mund të ndërtojmë një sistem më të drejtë dhe më të fuqishëm, i cili mbron ata që guxojnë të flasin dhe mbron interesin publik, duke kundërshtuar çdo përpjekje për ta shndërruar ligjin në një mjet shtypjeje kundër demokracisë.

Vetëm përmes aktivizimit të përbashkët mund të sigurohemi që liria e shprehjes dhe demokracia të mbeten të pacenuara!

Shtojca: Cilat janë rastet më të njohura të padive SLAPP në Kosovë?

Në Kosovë, ndër rastet më të njohura të padive SLAPP është padia e ngritur kundër aktivistes Shpresa Loshaj dhe ndaj analistit Agon Demi. Këto padi u panë si përpjekje për të frikësuar dhe ndaluar aktivistët nga adresimi i çështjeve publike me rëndësi të madhe, si ndikimi i hidrocentraleve në mjedis dhe keqmenaxhimi i parasë publike.

Kompania "Kelkoss Energy" kundër aktivistes Shpresa Loshaj

Me 1 qershor 2020, Kompania "Kelkoss Energy" kishte parashtruar padi ndaj aktivistes së mbrojtjes së mjedisit dhe themelueses së organizatës joqeveritare "Pishtarët", Shpresa Loshaj, pranë Gjykatës Themelore të Pejës, Dega në Deçan. Në këtë padi, "Kelkoss Energy" kërkoi dëmshpërblim prej 100,000 euro nga Loshaj për dëmin e shkaktuar me fushatën e saj publike kundër veprimtarisë së "Kelkoss Energy" në rajonin e Deçanit, ku kompania menaxhonte katër hidrocentrale.

Sipas përmbajtjes së padisë, që nga maji i vitit 2020, Loshaj kishte dalë publikisht duke kritikuar veprimtarinë e "Kelkos Energy", duke vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e operacioneve të saj dhe duke theksuar ndikimin negativ në mjedis dhe burimet natyrore. Ajo argumentonte se licenca e kompanisë për prodhimin e energjisë ishte në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë.

Në padi, "Kelkos Energy" kërkonte që Loshaj të tërhiqte deklaratat e saj, të kërkonte falje publike, dhe të shmangte në të ardhmen publikimin e deklaratave të tilla që kompania i konsideronte të pavërteta dhe të dëmshme për reputacionin e saj.

Rasti nxiti reagime nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat përmes krijimit të një Koalicioni Ad-Hoc kërkuan nga kompania që të tërhiqte menjëherë padinë, duke e cilësuar atë si një përpjekje për të frikësuar dhe heshtur aktivistët.

Si rezultat i këtij presioni publik, më 18 tetor 2021, "Kelkos Energy" paraqiti një shkresë në gjykatë, duke njoftuar se kishte vendosur të tërhiqte padinë ndaj Loshajt. Ky vendim u konsiderua një fitore për lirinë e shprehjes dhe aktivizmin mjedisor në Kosovë.

Radio i Televizioni i Kosovës (RTK) kundër aktivistit Agron Demi

Me 15 prill 2020, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte parashtruar padi për shpifje ndaj aktivistit dhe analistit të politikave në Institutin GAP, Agron Demi.

Transmetuesi publik i Kosovës e kishte paditur Demin, duke pretenduar që kritikën e Demit përmes statuseve në rrjetin social "Facebook", të shoqëruara me kërkesën për mbyllje të transmetuesit publik, përbëjnë gjuhë të urrejtjes dhe fyerje ndaj televizionit dhe punonjësve të tij.

Përkatësisht, objekt i kësaj padie ishte postimi i Demit në rrjetin e tij social "Facebook", i bërë me datë 13 mars 2020, ku ndër të tjera kishte shkruar:

"E kisha shtu edhe një masë për ruajtjen e shëndetit: mbylljen e menjëhershme të RTK-së.."

Sipas padisë, me deklaratat e lartcekura i padituri ka krijuar një kampanjë kundër Radio Televizionit të Kosovës duke shpifur dhe fyer atë, me ç'rast ka kërkuar që i padituri të kërkojë falje publikisht dhe të tërheqë deklaratat shpifëse dhe fyese ndaj RTK-së, si dhe i njëjti të premtoj se deklaratat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Edhe ky rast nxiti reagime të shumta në mesin e shoqërisë civile. Rrjedhimisht, me 26 janar 2022, RTK ka dërguar një shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me ç'rast ka njoftuar se e ka tërhequr padinë ndaj Agron Demit. Edhe ky rast u pa si një fitore për lirinë e shprehjes dhe kritikën e lirë ndaj institucioneve publike.





British Embassy
Pristina